

Pyetje për SRC nga Audienca

1. Çfarë është bërë për sigurinë e nxënësve nga ana e policisë së shkollave dhe për vizitat në infermierinë e shkollave?

Policia e Shkollës:

- Policia e shkollës punon ngushtësisht me Drejtorin dhe Policinë e Filadelfias, për koordinimin e punës të sigurisë së shkollave
- Drejtorët dhe Policia e shkollës, janë trajnuar mbi politikat dhe procedurat e përshkruara në Kodin e Sjelles së Nxënësit
<http://philasd.org/offices/administration/policies/118.html>
- Përkthimet e Kodit të Sjelles së Nxënësit mund të shkarkohen këtu:
<https://webapps.philasd.org/tdm/search/Albanian/yxzwCode#results>
- Për shqetësime imediate, ndaj sjelljeve kërcënuese, ju mund të kontaktoni linjën e Hapur për Sigurinë dhe Sjelljet Kërcënuese (Bullying and Safety Hotline) me numër 215-400-7233. Ju mundet gjithashtu të plotësoni online formularin në www.philasd.org/language/albanian/-allegation-of-bullying

** Ka rëndësi shumë të madhe që nxënësit të raportojnë menjëherë për çdo problem që mund të kenë. Nxënësit mund të kontaktojnë mësuesin e ESOL-it, Asistentin Dygjuhësh të Këshilltarit (BCA), ose këshilltarin e shkollës, kur kanë nevojë për ndihmë në lidhje me shqetësimin e tyre.*

Infermierët e Shkollës:

- Çdo nxënës ka akses te një infermier i shkollës; megjithatë, kjo nuk mund të realizohet çdo ditë. Drejtoria Arsimore e Filadelfias zbaton udhëzimet e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë (PDE) duke caktuar një infermier për 1500 nxënës.
- Shkollat janë të paisura me udhëzues për Politikën e Ndhmës së Parë dhe gjithë personeli është përgjegjës për zbatimin e këtyre udhëzimeve.
- Nxënësit që janë në nevojë për probleme specifike të shëndetit, paisen me një plan kujdesi nga infermieri i shkollës në bashkërendim me të gjithë personelin e shkollës. Për identifikimin e nevojave shëndetësore specifike të nxënësit, prindërit duhet të plotësojnë “Formularin për Urgjencën e Nxënësit” (Student Emergency Form) dhe ta dorëzojnë te Drejtori i shkollës. Ky formular në gjuhën

shqip mund të shkarkohet nga:

<https://webapps.philasd.org/tdm/search/Albanian/wyzyEmerg#results>

2. Çfarë hapash duhet të merren për zgjerimin dhe mbështetjen e bashkëpunimit midis shkollave të Drejtorisë Arsimore dhe organizatave komunitare shumëkulturore/shumëgjuhësore?

- Zyra e Mbështetjes të Familjes Shumëgjuhësore, e përfshirë në Zyrën e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE) ka zhvilluar dhe mban një bashkëpunim të ngushtë me organizata, që ju shërbejnë imigrantëve/refugjatëve; merr pjesë në takimet individuale (me drejtues komuniteti dhe organizatash fetare) dhe kolektive (bashkëpunuese); dhe komunikon me organizatat e imigrantëve/refugjatëve dhe të interesuar nga komuniteti duke i informuar me problemet e Drejtorisë, burimet dhe mundësitë e qytetit, shtetit dhe ato kombëtare. Nëpërmjet aktiviteteve mirëseardhëse (“Welcome Wagon Activities”), Zyra e Mbështetjes së Familjeve Shumëgjuhëshe, vetëm dhe në bashkëpunim me organizatat e komunitetit dhe ato me bazë fetare, ofron trajnime për prindërit, të interesuarit dhe partnerët e komunitetit. Në synimin e saj për përdorimin e shumë mjeteve në arritjen e komunitetit që ka mangësi në përdorimin e Anglishtes, Qendra e Përkthimeve dhe Interpretimeve e Zyrës së Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE) vazhdon të zgjerojë gamën e shërbimeve që përfshin një arkivë të dokumentave të përkthyer dhe faqeve të internetit në nëntë (9) gjuhët më të përdorura në Drejtorinë Arsimore.

www.philasd.org/language/albanian

- Aktualisht, Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe (OMCP) në bashkëpunim me disa organizata ofron programe jashtëshkollore dhe verore për Nxënësit që mësojnë Anglisht (ELL). Për më tepër informacion për këto programe dhe/ose si kryhet bashkëpunime me OMCP, ju lutemi kontaktoni Diane J. Kim (dkim@philasd.org).
- Organizatat me Bazë Komunitare (CBOs) mund të kontaktojnë me OMCP, nëse ato dëshirojnë takim me përfaqësuesit e zyrës. OMCP së shpejti do të organizojë takime me komunitetin në pjesë të ndryshme të qytetit.

3. Si mund të zgjerohet punësimi i BCA_ve duke i shtrirë në të gjitha shkollat?

Punësimi i Asistentë Këshilltarëve Dygjuhësh (BCA), është krejtësisht një çështje që lidhet me buxhetin dhe fondet federale që janë në dispozicion përmes ligjit Title III. Që prej shkurtimeve më të mëdha buxhetore të Drejtorisë në vitin 2011, pozicioni i

BCA_ve nuk ka arritur numrin e mëparshëm të tyre (103). Aktualisht janë 57 BCA.

4. A është përparësi e SRC punësimi i më shumë BCA_ve (shumë shkolla kanë BCA vetëm një herë në javë) dhe tutorëve të ESOL_it?

Caktimi i BCA_ve është bërë nëpërmjet të dhënave të Drejtorisë Arsimore mbi gjuhët e folura në familjet (vetëdeklarimet e prindërve për gjuhën amtare gjatë procesit të regjistrimit), si dhe nëpërmjet ndryshimeve demografike që janë kryer si rrjedhojë e ardhjes së imigrantëve në qytet. Sidoqoftë, idealja do të ishte që më mirë se të punësohen BCA, për zgjidhjen e problemeve thelbësore që hasin familjet shumëgjuhëshe, mbështetja që kërkohet shtrihet përtej BCA_ve. Të gjithë edukatorët e Drejtorisë ndajnë përgjegjësi për edukimin dhe mbështetjen e familjeve dhe nxënësve shumëgjuhësh.

5. Cili është qëndrimi juaj në edukimin dygjuhësh? Shumë kërkime kanë treguar se nxënësit dygjuhësh përparojnë shpejt dhe mirë. A nuk e forcon kjo gjithashtu edhe bashkëpunimin, meqenëse nxënësit dhe shkollat janë duke përdorur gjuhët amtare?

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe është duke punuar për përmirësimin dhe shtrirjen e programeve mësimore dygjuhëshe në shkollat e drejtorisë arsimore. Aktualisht janë pesë (5) programe mësimore dygjuhëshe— katër (4) Programe Edukimi Dygjuhëshe Tranzitore (TBE) (Transitional Bilingual Education) dhe një program Dy Gjuhësh (Dual Language). Këtë vit, Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe në bashkëpunim me Dr. Nelson Flores dhe Universitetin e Pensilvanisë (University of Pennsylvania) ofron programe kualifikimi për mësuesit dygjuhësh (bilingual education teachers) në të gjithë programet tona dygjuhëshe. Ky kualifikim profesional përfshin seminare që mbahen ditëve të Shtuna, ku mësuesve u paraqiten njohuritë më të fundit në edukimin dygjuhësh si dhe mbështetje në shkollat e tyre, kur fillojnë të implementojnë synime të identifikuar, të cilat përkojnë me linjën e përmbajtjes së seminareve.

Aktualisht të gjitha programet tona në Mësimin Dygjuhësh dhe Programet e Edukimit Dygjuhëshe Tranzitore, janë Spanjisht/Anglisht.

Shkollat e mëposhtëme ofrojnë Programe Edukimi Dygjuhëshe Tranzitore:

Alexander McClure School
600 W. Hunting Park Avenue
Philadelphia, PA 19140
Phone: 215-456-3001

Cayuga School
4344-4358 N. 5th Street
Philadelphia, PA 19140
Phone: 215-456-3167

Lewis Elkin School
3199 D Street
Philadelphia, PA 19134
Phone: 215 291-4701

Bayard Taylor School
3698 N. Randolph Street
Philadelphia, PA 19140
Phone: 215-227-4435

Shkollat e mëposhtëme ofrojnë Programe Dygjuhëshe:

Hon. Luis Muñoz-Marin School
3300 North 3rd Street
Philadelphia PA, 19140

6. Në vazhdim, cili është kuptimi juaj për komunitetin? Ne themi, që po angazhojmë prindërit, por rrallë e shikoj këtë, zakonisht janë prindërit ata që angazhojnë shkollat.

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe do të fillojë të kryej takime të rregullta me të gjithë të interesuarit. Informacioni për takimin e parë me të interesuarit mund të gjendet këtu ([linku në PDF e fletushkës](#)). Gjatë këtyre takimeve ne do të punojmë të realizojmë rrugët më të mira që Drejtoria të përfshijë prindërit dhe partnerët e komunitetit.

7. A është përparësi e SRC që të ulë ngarkesën e mësuesve të ESOL? Disa prej tyre kanë më shumë se 50 nxënës.

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe i shpërndan mësuesit e ESOL nëpër shkolla bazuar në numrin e ELL_ve në shkolla dhe shkallës së përvetësimit të gjuhës prej tyre. Mësuesit e ESOL punojnë në bashkëpunim me mësuesin e klasës për mbështetjen e mësimit të lëndëve nga ana e ELL_ve—kjo është një përgjegjësi e ndarë bashkërisht. Më tepër informacion për rolin dhe përgjegjësinë e mësuesve të ESOL mund të gjeni në broshurën [Broshura Programi Mësimor i ELL \(The ELL Education Program Handbook\)](#), i cili mund të shkarkohet këtu: <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/m/multilingual-education/policies--procedures>

8. Ju lutemi shpjegoni grafikun e të dhëna të Testit ACCESS. Pse ne si Drejtori Arsimore jemi në rënie në përqindjen përvetësimit të Anglishtes nga ana e ELL_ve?

Ndërsa ne i kemi shtrirë objektivat e vendosura nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë (PDE) për tre vitet e shkuara, të dhënat e përgjithëshme të testit ACCESS flasin se numri i nxënësve që përvetësojnë Anglishten dhe bëjnë përparim në mësimin e gjuhës Angleze, është me një ulje të lehtë. Në përgjigje të kësaj uljeje, Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe po punon me Drejtorët dhe mësuesit që të analizojë të dhënat e testit ACCESS, në lidhje edhe me fusha të tjera, që të japë udhëzimet mësimore dhe vendime programore në nivelin e shkollës. Në vazhdim, të dhënat e testit ACCESS po përdoren në nivel Drejtorie për marrjen e vendimeve, që lidhen me kualifikimin profesional dhe politikave mësimore në shkallë drejtorie.

9. Veçanërisht në termat e vlerësimit, kur do të vazhdojë bashkëbisedimi për ELL_të dhe vlerësimi përkatës i duhur?

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe do të fillojë të kryej takime të rregullta me të gjithë të interesuarit. Informacioni për takimin e parë me të interesuarit mund të gjendet këtu (linku në PDF e fletushkës). Në këtë takim ne do të rishikojmë të gjitha çështjet e ngritura gjatë takimit të SPP . Plani jonë është vazhdimi i bashkëbisedimit nëpërmjet takimeve të rregullta të personave të interesuar, si dhe të mbledhim mendime, të cilat do të përfshihen në vendimet që do të marrë Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe.

10. Si mundet Drejtoria Arsimore të ndërmarrë hapa konkretë për vlerësimin dhe trajtimin e ELL_ve dhe nxënësve shumëgjuhësh si vlera të saj dhe jo si një barrë?

Në Drejtorinë Arsimore ka shumë mësues të cilët vlerësojnë dhe përqafojnë vlerat kulturore dhe gjuhësore, që nxënësit shumëgjuhësh sjellin në shkollat dhe komunitetet tona. Megjithatë, për një numër shkaqesh, disa mësues janë të bezdisur nga sfidat që kërkohen për plotësimin e nevojave të ELL_ve dhe nuk i njohin sa duhet këto vlera. Për trajtimin e këtyre problemeve, mësuesit janë thirrur në një numër takimesh për kualifikimet profesionale nga Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe dhe Zyra e Mbështetjes të Familjeve Shumëgjuhëshe. Në këto sesione janë trajtuar çështje të dygjuhësisë, diversitetit kulturor dhe qasjeve për t'u shërbyer sa më mirë ELL_ve dhe nxënësve shumëgjuhësh. Një hap tjetër që drejtoria mund të ndërmarrë për trajtimin e këtyre problemeve është bashkëpunimi me organizatat e komunitetit që janë të gatshme të ndajnë ekspertizën e tyre kulturore dhe gjuhësore me personelin e shkollës. Ne shpresojmë që përmes takime të ardhëshme me komunitetin dhe personat e interesuar, të nxitim më tej këtë bashkëpunim.

11. Çfarë është bërë për përmirësimin e drekës që shërbehet në shkollë?

Zyra e Shërbimeve të Ushqimit ka informacion të detajuar rreth drekës që shërbehet në shkollë. Kjo zyre gjithashtu ofron këshilla për prindërit dhe nxënësit, që janë të interesur për përmirësimin e drekës që shërbehet në shkollë. Për më shumë informacion dhe për pyetjet që bëhen më shpesh, ju lutemi vizitoni http://webgui.phila.k12.pa.us/uploads/ZF/2S/ZF2SPZ7dfD4mv1adSc_3mg/Nutrition-Program-FAQs.pdf

Komentet e Audiencës:

1. Sot, çdo nxënës dhe i rritur ka folur për rëndësinë e marrdhënieve me ELL_të. Unë shpresoj që Komisionerët e SRC dhe Mr. Kihn ta mbajnë parasysh këtë, ndërsa lëvizin mësuesit nëpër shkolla të ndryshme dhe në këtë mënyrë prishin këtë marrdhënie, si edhe kur ata krijojnë shkolla të transformuara, shkolla Charter dhe ato në Rilindje.
2. Unë jam shumë i preokupuar për familjet Vietnameze, pasi ata nuk marrin mbështetjen e mjaftueshme nga BCA_të Vietnamezë. Nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e ndihmës nga BCA_të Vietnamezë, pasi ata janë në shkollë vetëm një ditë në javë. Ne kërkojmë që BCA_të Vietnamezë të jenë më tepër se një ditë në një shkollë. Aktualisht janë vetëm pesë (5) BCA Vietnamezë në të gjithë Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

**Ju lutemi shikoni përgjigjet për pyetjen e tretë, në lidhje me BCA_të.*